



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1300/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren individuale Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit, në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, E.nr.2898/2010, i datës 12.04.2021, me datë 22.08.2022, mori këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, E.nr.2898/2010, i datës 12.04.2021.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar E.nr.2898/2010, i datës 12.04.2021, ka vendosur të refuzoj si të pabazuar propozimin për përmbarim të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, i datës 30.11.2020.

Kundër aktvendimit E.nr.2898/2010, i datës 12.04.2021, me të cilin është refuzuar propozimi për përmbarim, i kreditorit me kohë ka paraqitur ankesë kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të aktvendimit të Doganës së Kosovës- Departamenti i Kufijve me nr. 03.1 nr.001 i datës 24.03.2010.

Gjykata në shkallë të parë, sipas propozimit të kreditorit me propozimin për ekzekutim të datës 30.11.2020, ka refuzuar propozimin për përmbarim duke vlerësuar se aktvendimi i Doganës së Kosovës- Departamenti i Kufijve me nr. 03.1 nr.001 i datës 24.03.2010, nuk i plotëson kushtet si vendim përmbarues i dhënë në procedurë administrative.

Kundër urdhrit përbarimor debitori nuk ka paraqitur prapësim .

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur që propozimin për përbarim të kreditorit ta refuzoj si të pa bazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, se ne baze te dokumentit përbarimor- aktvendimit të Doganës së Kosovës- Departamenti i Kufijve me nr. 03.1 nr.001 i datës 24.03.2010, i formës së prerë nga data 29.04.2010, i ekzekutueshëm nga data 20.05.2010, debitorit i është shqiptuar gjoba e cila nuk është e përcaktuar në dispozitiv të aktvendimit e as në arsyetim, të cilën është detyruar që të ja paguaj kreditorit në afatin prej 7 ditësh prej momentit të pranimit të vendimit.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Dogana e Kosovës, ne rastin konkret nuk është dokument përbarues, ashtu siç parashihet ne nenin 27 paragrafi 1 te LPP-ës e cila dispozitë përcakton së: : *“dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim ne qofte se ne te është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit”*.

Andaj, pretendimet ankimore te kreditorit se shuma është përcaktuar në propozim për përbarim nuk qëndrojnë sepse dokumenti përbarimor në këtë rast aktvendimi i Doganës së Kosovës- Departamenti i Kufijve me nr. 03.1 nr.001 i datës 24.03.2010, nuk i plotëson kushtet si vendim përbarues, andaj edhe pretendimet se gjykata ka bere shkelje te dispozitave te LPP-ës, me rastin e refuzimit prapësimi nuk qëndrojnë sepse në procedurën përbarimore behet realizimi direkt i mbrojtjes juridike te konstatuar ne dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me te cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues qe sipas propozimit te kreditorit te caktoj dhe zbatoi përbarimin.

Nuk qëndrojnë pretendimet për plotësimin e kushteve për lejimin e përbarimit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përbarimore, vlerëson nëse janë plotësuar kushte për nxjerrjen e urdhrit përbarimor.

Në rastin konkret Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-ës.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1300/22, data 22.08.2022

Gjyqtarja
Saranda Bogaj Sheremeti